



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 dhe neni 26 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 4 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 për Certifikim të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 26.08.2021 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për certifikimin e subjektit politik **Lëvizja Qytetare Vatra (LQV)** dhe listës prej 36 (tridhjetë e gjashtë) kandidatëve për Kuvend Komunal dhe 1 (një) kandidati për Kryetar të Komunës në Komunën e Gjilanit, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
- II. Ky subjekt politik certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend Komunal dhe Kryetar të Komunës në Komunën e Gjilanit.
- III. Zyra obligohet që të njoftoj partinë politike **Lëvizja Qytetare Vatra**, për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Subjekti politik i çertifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për radhitjen në fletëvotim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Redoniqi



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa – PZAP.